

AKT THEMELIMI

I shoqerisë tregtare "Real Project" sh.p.k

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqiperisë , në ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 " Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit" , tëligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Për shoqeritë tregëtare" dhe të ligjit Nr.9723 , datë 06.05.2019 "Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare , me vullnetin e tij të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi në ortaket :

- 1.Blerina Boja
- 2.Gentila Bakiu

individë me përgjegjesi të kufizuar, banues në Tiranë, të krijojnë shoqerinë tregtare me përgjegjesi të kufizuar "Real Project" sh.p.k me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur Real Project sh.p.k . Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqipëtar , ndërsa degët që mund të krijoen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

Selia e Shoqerisë

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare private "Real Project" sh.p.k do të ketë selinë në rrugën "Jordan Misja" , Hyrja 3 , Tiranë .Shoqeria mund të ndryshojë seline e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve të vetëm.

Objektivi I Veprimtarise

Neni 3

Kompania "Real Project" shpk nëpërmjet studios së saj të projektimit dhe bashkëpunimit me të tretë do të realizojë botime të cdo lloji: libra, revista etj. Këto botime do ti tregtojë brenda dhe jashtë vendit.



Kohëzgjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqeërise do të jetë me një afat kohor të papërcaktuar . Ajo mund shpërbehet ne cdo kohe dhe për çfardo lloj shkaku .

Kapitali I Shoqërisë

Neni 5

Kapitali filletar i shoqërisë private “Real Project” sh.p.k do të jetë 10.000 (njëqind mijë lekë).

Kapitali është : 51% Blerina Boja

49% Gentila Bakiu

Kapitali filletar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themelëtar filletar).

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori/e saj Znj.Gentila Bakiu dhe Znj. Blerina Boja.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërise i takojnë të dy ortakëve në mënyrë të barabartë.

Neni 8

Ortakët ka të drejte të emërojnë edhe administratorë të tjera të vlerave materiale.

Ka të drejtë të caktojë financiere , likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë .

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .



Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërisë Tregëtare" , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen shoqëri .

Neni 12

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t'ju shpérndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "Real Project" sh.p.k

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga të dy ortakët

Ortakët themelues "Real Project" sh.p.k:

BLERINA BOJA

GENTILA BAKIU

Blerina Boja

ay

Gentila Baku

Bak

G